



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 4023/Prot.
4

Tiranë, më 06-12 2021

VENDIM

Nr. 44, datë 25.11. 2021

“Për hapjen e programit me diplomë të dyfishtë/double degree me Universitetin Sorbonne Paris Nord, Francë dhe Universitetin e Tiranës, në nivelin Master Shkencor, në fushën e “Trajtimit Automatik të Gjuhëve”, për vitin akademik 2022-2023”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma b; neni 35, pika 1, neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 80; Udhëzimin e MASR-së Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu IV, gërma “A”, i ndryshuar, Udhëzimin e MASR-së nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Kreu I, pika 2, i ndryshuar dhe Statutin e Universitetit të Tiranës neni 31, gërmat f), j) dhe cc), neni 100; si dhe në propozimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja me shkresën Nr. 928/2 Prot., datë 17.11.2021, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 25.11.2021;

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit me diplomë të dyfishtë/double degree me Universitetin Sorbonne Paris Nord, Francë dhe Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në nivelin Master i Shkencave, në “Natural Language Processing”/ “Traitement Automatique des Langues”, për vitin akademik 2022-2023.
2. Të miratojë formën e diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Natural Language Processing”/ “Traitement Automatique des Langues”., të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.
3. Dokumentacioni përkatës të përcillet për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
4. Dokumentacioni përkatës të përcillet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF. DR. ARTAN HOXHA